



TE GJITHA PYETJET VLERESOHEN ME NGA 4 PIKE

1. Elektronet rrotullohen rreth bërthamës sepse tërhiqen nga:



- A) Forca bërthamore
- B) Forca elektrike
- C) Forca Atomike
- D) Forca mekanike
- E) Forca elektrostатike

2. Në secilën nga diagramat më poshtë tregohen dy forca me madhësi të njëjtë që veprojnë mbi një pikë lëndore ose grimcë. Në cilin rast, forca rezultante ka të njëjtën madhësi me njërën prej tyre?



- A) Fig. 1
- B) Fig. 2
- C) Fig. 3
- D) Fig. 4
- E) Nuk është e mundur


3. Atomi është një grimcë e njohur shumë kohë më parë. Cilët nga studiuesit më poshtë ka zbuluar teorinë e atomit?



- A) Leucippus
- B) Anaximenes
- C) Thales
- D) Pythagoras
- E) Aristotle

4. Në brendësi të lëngut:

- A. Shtypja zvogëlohet me rritjen e thellësisë
- B. Shtypja është e njëjtë në thellësi të njëjtë, pavarësisht llojit të lëngut
- C. Në një metër thllësi në cdo lëng, shtypja është e njëjtë në cdo drejtim
- D. Në një metër thellësi, shtypja është e njëjtë, pavarësisht temperaturës së lëngut
- E. Shtypja matet me dynamometer

5. Cilet jane koeficientet e sakte (duke lexuar nga e majta ne te djathte) kur reaksioni kimik eshte i ballancuar?

- | | | |
|----------------|---------------|----------------|
| | B | |
| A) 1,4,8,1,4,8 |) 1,8,4,1,8,4 | C) 4,8,1,8,4,1 |
| | E | |
| D) 4,1,8,4,1,8 |) 1,8,4,4,8,1 | |

6. Një predhë lëshohet nga toka me një kënd të caktuar. Cila nga shprehjet më poshtë është e saktë kur rezistenca e ajrit merret si e papërfillshme.

- A. Nxitimi në drejtim horizontal i tij është 10 m/s^2
- B. Nxitimi në drejtim vertikal i tij zvogëlohet gjatë fluturimit
- C. Shpejtësia e tij në drejtim vertikal është e njëtrajtshme
- D. Zhvendosja maksimale në drejtim vertikal quhet rreze rënëse(range) e trupit
- E. Këndi që formohet me tokën është i njëjtë si në rastin kur ngjitet lart po ashtu dhe kur bie poshtë.


7. Cili nga pohimet e mëposhtem shpreh një fenomen kimik?

- a. Bymimi i shinave të trenit
- b. Ngarkesa elektrostatiske e pjesezave
- c. Djegia e drurit
- d. Shkrirja e sheqerit
- e. Tretja e sheqerit

8. Kur rrezja e dritës kalon nga një mjedis me indeks përthyerje të vogël në një mjedis me indeks përthyerje më të madhe atëherë:

- A. Shpejtësia e dritës mbetet e njëjtë dhe rrezja ka të njëjtin drejtim
- B. Shpejtësia e dritës rritet dhe rrezja përthyeret duke ju afruar normales
- C. Shpejtësia e dritës zvogëlohet dhe rrezja përthyeret duke ju afruar normales
- D. Shpejtësia e dritës mbetet e njëjtë dhe rrezja përthyeret duke ju afruar normales
- E. Shpejtësia e dritës mbetet e njëjtë dhe rrezja përthyeret duke ju larguar normales

9. Ne reaksionin e mëposhtem te percaktohet se cila prej substancave ne kushte standarte eshte ne gjendje te gazte.



- A) CaCO_3 dhe CaCl_2
- B) CaCO_3 dhe H_2O
- C) CaCl_2 dhe HCl
- D) H_2O dhe CO_2
- E) HCl dhe CO_2

10. Dy trupa lëvizin në drejtim të njëri tjetrit, të cilët përplasen duke përformuar një përplasje elastike. Nëse të dy trupat kanë të njëjtën masë cilat nga shprehjet e mëposhtme është e saktë?

- A. Shpejtësitë pas përplasjes do të jenë të barabarta
- B. Të dy trupat do të ndalojnë pas përplasjes
- C. Shpejtësitë e trupave do të kenë të njëjtën madhësi dhe kahe të kundërta
- D. Njëri nga trupat do të ndalojë dhe shpejtësia e trupit tjetër do të dyfishohet
- E. Trupat shkëmbejnë shpejtësitë e tyre

11. Te percaktohet se cila nga sekuencat e mëposhte i rradhiti pikat e vlimit te ketyre substancave nga vlera me e madhe tek vlera me e vogel.



- A) $\text{HF}, \text{CH}_3\text{OH}, \text{C}_2\text{H}_5\text{OH}, \text{H}_2\text{O}$
- B) $\text{CH}_3\text{OH}, \text{C}_2\text{H}_5\text{OH}, \text{HF}, \text{H}_2\text{O}$
- C) $\text{CH}_3\text{OH}, \text{HF}, \text{C}_2\text{H}_5\text{OH}, \text{H}_2\text{O}$
- D) $\text{H}_2\text{O}, \text{HF}, \text{CH}_3\text{OH}, \text{C}_2\text{H}_5\text{OH}$
- E) $\text{CH}_3\text{OH}, \text{HF}, \text{H}_2\text{O}, \text{C}_2\text{H}_5\text{OH}$

12. Cila nga shprehjet është e saktë rreth potencialit elektrik

- A. Ka gjithmonë vlerë të barabartë me fushën elektrike
- B. Është madhësi vektoriale
- C. Është sasia e energjisë e nevojshme për të lëvizur një sasi ngarkese nga një pikë referimi në një pikë tjetër
- D. Ka vlerën zero kur ngarkesa është në një fushë elektrike
- E. Njësia e potencialit elektrik është kulon

13. Ne industrinë e perpunimit të ushqimeve, cili nga metalet e mëposhtem karakteristikat e të cilit janë; jo toksik, i butë dhe rezistent ndaj korrozionit; gjen përdorim?

- A) Cu
 - B) Cr
 - C) Zn
 - D) Pb
 - E) Sn
-

14. Një trup është i varur në një dinamometër i lidhur në tavanin e një ashensori. Kur ashensori zbrit me nxitim, dinamometri tregon vlerën 6 N, dhe kur ngjitet lart me të njëjtin nxitim, tregon vlerën 14 N.

Cila në shprehjet më poshtë tregon vlerat e sakta për masën e trupit dhe nxitimin e ashensorit?

- A. 1 kg ; 4 m/s²
- B. 4 kg ; 1 m/s²
- C. 2 kg ; 2 m/s²
- D. 0.5 kg ; 8 m/s²
- E. 0.5 kg ; 2 m/s²

15. Propani perftohet nga dehidratimi i 4 L alkoli izopropilik, dendësia e të cilit është ($\rho = 0.9 \text{ g / cm}^3$)

Te llogaritet Vëllimi i propanit të ciluar në kushte standarte.

- A) 1344 mL
- B) 2.016 L
- C) 13.44 L
- D) 2.52 L
- E) **1344**

16. Plotësoni shprehjen duke zgjedhur frazën e duhur.
Forca elektromotive krijohet...

- A. Në një përcjellës që lëviz paralel me vijat e fushës magnetike
- B. Nëse një magnet ndodhet brenda spiraleve/bobine
- C. Në një tel përçues që është i përkulur në një lak dhe përshkohet nga një konstante kohore
fluksi magnetik
- D. Kur një magnet hyn dhe del në një spirale elektromagnetike
- E. Në çdo spirale elektromagnetike të përshkuar nga një fushë magnetike e qëndrueshme në kohë

17. Alkoli metilik eshte nje djeges shume i mire dhe cliroh perafersisht 7000 Kcal/Kg. Sa nxehtesi do te clirohen nga djegia e 20 moleve alkol metilik?

Masat atomike: C - 12; H - 1; O - 16

- A) 140000 Kcal B) 448000 Kcal C) 4480 Kcal
- D) 1400 Kcal E) 14000 MJ

18. Plotësoni shprehjen duke zgjedhur frazën e duhur.

Imazhi real/ i vërtë i një trupi do të shfaqet...

- A. Pas një pasqyre të rrafshët
B. Pas një thjere shpërhapse
C. Pas një thjere përmbledhëse
D. Përpara një pasqyre të lugët
E. Përpara një thjere përmbledhëse

19. Cila nga alternativat e mëposhtme është e gabuar?

- A) Sakaridet janë substanca që sigurojnë energji për trupin e njeriut
B) Glukoza është një monosakarid i ëmbël
C) Proteinat mund të kenë një rol ndërtues
D) Hidroliza e niseshtës jep fruktozë
E) Aminoacidet nuk janë pjesë e proteinave

20. Cila nga madhësitë mbetet e pandryshueshme, kur një planet rrotullohet rreth Diellit?

- A. Rrezja e trajektorës së rrotullimit
B. Forca Gravitacionale
C. Shpejtësia
D. Energjia kinetike e planetit
E. Momenti kinetic

21. Cila nga seritë e mëposhtme përmban proteina të tretshme?



- A) Kolagjeni, fibroina, albumina
- B) Albumina, globulina, mioglobina
- C) Hemoglobina, fibroina, keratina
- D) Kolagjeni, fibroina, keratina
- E) Elastin, fibroin, keratin

22. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vertetë për elementin U 238, 92

- a) Peshë atomike e tij është 92
- b) Ka 238 elektrone në gjendjen e tij neutral
- c) Ka 92 protone
- d) Ka 92 neutrone
- e) 238 paraqet numrin e protoneve dhe elektroneve në një atom të këtij elementi

23. Cili nga pohimet e mëposhtme është i rremë?

- A) Proteinat janë komponime makromolekulare të marra nga polikondensimi i aminoacideve
- B) Molekula e etanolit formohet nga lidhje të thjeshta midis atomeve përbërës
- C) Vitaminat e tretshme në ujë janë vitaminat B dhe C
- D) Etanoli është i tretshëm në ujë
- E) Vitaminat e tretshme në yndyrë treten në ujë

24. Dy sfera metali me madhësi të njëjtë janë të ngarkuara 12 C de -4 C përkatësisht dhe janë të vendosura mbi një pjatë me material jopërcjellës. Ata vihen në kontakt me njëri tjetrin dhe vihen sërish në pozicionin e tyre fillestar. Si ndryshon forca e tyre e bashkëveprimit?

- A. Sferat shtyjnë njëra tjetrën me një forcë tre herë më të vogël se në fillim
- B. Sferat tërheqin njëra tjetrën si në fillim por më një forcë tre herë më të madhe
- C. Sferat tërheqin njëra tjetrën si në fillim por më një forcë tre herë më të vogël
- D. Sferat shtyjnë njëra tjetrën si në fillim me të njëjtën forcë
- E. Sferat tërheqin njëra tjetrën si në fillim me të njëjtën forcë

25. Cili nga ushqimet e mëposhtme përmban sasi më të lartë të proteinave?



a) banana



b) bizele



c) qepe



d) lulelaker



e) fasule

26. Një top me masë 0.5 kg, me shpejtësi 10.0 m/s hidhet pingul drejt sipërfaqes së një muri. Pasi topi godet murin, kthehet mbrapsht me shpejtësi sa gjysma e shpejtësisë fillestare. Nëse topi ushtron një forcë me vlerë mesatare 750 N, sa është koha e kontaktit të topit me murin?

- A. 1 min
- B. 0.01 s
- C. 1 h
- D. 1 ms
- E. 1 s

27. Cila nga ushqimet e mëposhtme ka përmbajtjen më të lartë të yndyrës?

- A) Banane
- B) Bizele
- C) Kikirikë
- D) Farat e sojës
- E) Patëllxhanët

28. Nëse gjilpëra magnetike (busulla) qëndron mbi një përcjellës nëpër të cilën kalon rrymë elektrike, atëherë drejtimi i kësaj gjilpëre do të jetë:


- A. Në drejtim të polit gjeografik të jugut, pavarësisht pozicionit të përcjellësit
- B. Paralel me përcjellësin
- C. Në drejtim të polit gjeografik të veriut, pavarësisht pozicionit të përcjellësit
- D. Radial me axin e përcjellësit
- E. Pingul me përcjellësin

29. Zgjidhni frazën që përfundon saktë këtë deklaratë:

"Sukroza është".

- A) një polisakarid
- B) një substancë që me hidrolizë formon vetëm glukozë
- C) një substancë e ngurtë, amorfe, pa ngjyrë
- D) një substancë që tretet në ujë
- E) një substancë që nuk mund të hidrolizohet enzimatisht

30. Sa është diferenca potenciale U_{AB} në qarkun elektrik të dhëne mëposhtë?



A) 24 V

B) 18 V

C) 36 V

D) 12 V

E) 9 V

